

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7859  
E premte, 9 gusht 2024  
Çmimi 0.50

ShBA-ja: Kosova po vë në rrezik mundësitë që ne i kemi ndihmuar t'i krijojë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KANDIDATI PËR KRYEMINISTËR I PDK-SË, BEDRI HAMZA, VIZITON SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) | FAQE 3

## HAMZA IA RIHAP DYERT KOSOVËS NË SHTËPINË E BARDHË



Në ditën që Departamenti Amerikan i Shtetit ka kritikuar ashpër Qeverinë e Kosovës, Shtëpia e Bardhë i ka hapur dyert për kandidatin e PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza. Ai ka njoftuar se të enjten është takuar

me asistentin e posaçëm të presidentit amerikan Joe Biden. Hamza ka bërë me dije se gjatë takimit ka shpalosur planin e tij për Kosovën. Në këtë kontekst, Hamza ka thënë se ka marrë mbështetje të fuqishme nga

ShBA-ja për Kosovën. Vizita e Hamzës në Shtëpinë e Bardhë ka ngjallur reagime në Kosovë. Njohës të rrethanave politike dhe politikanë të ndryshëm kanë thënë se një vizitë e tillë është e mirëseardhur për Kosovën

## PAK SERBË NË DEBATIN PËR HAPJEN E URËS SË IBRIT



## BE-ja: NËSE SITUATA NUK NDRYSHON, MASAT NDAJ KOSOVËS MUND TË ASHPËRSOHEN



## AKTUALE



OFICERËT E FSK-së PËRFUNDOJNË ME SUKSES TRAJNIMIN NË SHBA PËR ARTILERI | F. 7

HARADINAJ BËN THIRRJE PËR KUJDES GJATË UDHËTIMEVE: SERBIA KA RIAKTUALIZUAR PËRNDJEKJEN E ISH-PJESËTARËVE TË UÇK-së | F. 3

ZGJATET AFATI PËR KONVERTIMIN E PATENTË-SHOFERËVE | F. 7

## EKONOMI



RIZVANOLLI: KOHA QË MARRËDHËNIET ME ITALINË T'I SHNDËRROJMË EDHE NË BASHKËPUNIM EKONOMIK | F. 8

MË 15 GUSHT MBAHET ANKANDI I DHJETË I LETRAVE ME VLERË PËR VITIN 2024 | F. 8

## SPORT



EKIPI I XHUDOS SË KOSOVËS NDERON DËSHMORËT DHE MARTIRËT E KOMBIT NË PREKAZ | F. 10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mok: +377 44 501 289  
E-mail: [renovamt.net.mk](mailto:renovamt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Izraeli zotohet se do ta eliminojë liderin e ri të Hamasit

**JERUSALEM, 8 GUSHT** - Izraeli është zotuar se do ta eliminojë Yahya Sinwar, udhëheqësin e ri të Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Sinwar besohet se ishte arkitekti i sulmit të 7 tetorit në Izrael në nxitje luftën në Gaza.

Emërimi i Sinwarit në krye të Hamasit ka ardhur pasi javën e kaluar në Teheran është vrarë shefi politik i grupit, Ismail Haniyeh.

Irani ka fajësuar Izraelin për vrasjen dhe është zotuar se do të kundërpërgjigjet. Izraeli nuk ka marrë përgjegjësinë për vrasjen e Haniyehut.

Duke folur gjatë vizitës në një bazë ushtarake, kryeministri

izraelit, Benjamin Netayahu, ka thënë se Izraeli është “i vendosur” ta mbrojë veten. “Ne jemi të përgatitur si në aspektin mbrojtës, po ashtu edhe në atë sulmues”, u ka thënë ai rekrutëve të rinj.

Shefi i ushtrisë, gjeneralletniant Herzi Halevi, është zotuar se “do ta gjejmë atë (Sinwarin) dhe do ta sulmojmë”. Ai ka thënë se Izraeli do ta detyrojë Hamasin që të gjejë një zëvendësues për Yahya Sinwarin.

Sinwar, lider i Hamasit në Gazë që nga viti 2017, nuk është parë që nga sulmi i 7 tetorit, që është sulmi më vdekjeprurës në historinë e Izraelit.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka deklaruar se është në dorën e Sinwarit të

ndihmojë në arritjen e armëpushimit, duke theksuar se ai ka qenë dhe vazhdon të jetë personi kryesor që merr vendime në grupin radikal.

Ndërsa analistët kanë thënë se Sinwar mund të jetë më hezitues që të pajtohet për një armëpushim në Gazë dhe është më i afërt me Teheranin sesa Haniyeh.

Lufta në Gaza ka nisur pasi Hamasit ka vrarë në veri të Izraelit afër 1 200 persona dhe rrëmbyer afër 250 të tjerë. Izraeli është kundërpërgjigjur me një ofensivë ajrore, tokësore dhe detare, që deri më tani ka lënë të vrarë pothuajse 40 mijë persona, teksa palestinezët në Gaza po përballen edhe me një krizë të thellë humanitare.



## Puigdemont kthehet në Spanjë pas shtatë vitesh në arrati dhe përballet me arrestimin

**BARCELONË, 8 GUSHT** - Ish-lideri katalanas Carles Puigdemont është kthyer në Spanjë për herë të parë që kur u largua nga vendi pas votimit të pavarësisë në vitin 2017.

Carles Puigdemont ka dalë para mbështetësve të tij në Barcelonë këtë të enjte, pasi ka kaluar shtatë vjet në mërgim të vetimponuar.

Puigdemont, ndaj të cilit ka një urdhër arresti për rolin e tij në një përpjekje të dështuar për pavarësi, u kthye në Spanjë për herë të parë pas përpjekjes.

Sipas “TV3”, policia katalanase ka nisur një operacion për gjetjen dhe arrestimin e Puigdemontit.

### Deklaratat e Puigdemontit

Puigdemont ka dalë në skenë i rrethuar nga zyrtarë të partisë së tij, Junts, për t’iu drejtuar mijëra ndjekësve që e brohorisin në katalanisht. “Edhe pse duan të na dëmtojnë, unë erdha këtu sot



për t’i kujtuar se ne jemi ende këtu. Ne nuk kemi të drejtë të dorëzohemi, sepse e drejta për vetëvendosje i përket popullit katalanas”. “Kurrë nuk do të jetë krim mbajtja e një referendumi”, ka thënë Puigdemont.

Puigdemont ishte planifikuar të merrte pjesë në seancën e parlamentit rajonal të së enjtes, ku ishte planifikuar ta bënte betimin një lider i ri rajonal, pas zgjedhjeve të majit, në të cilat partia separatiste e linjës së ashpër të Puigdemont, Junts, ka

dalë e dyta. “Që për ta bërë këtë rrezikoj ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm, tregon anomalinë demokratike që ne kemi për detyrë ta denoncojmë dhe ta luftojmë”, ka thënë ai në një video të publikuar në rrjetet sociale.

### Pse mund ta arrestojnë?

61-vjeçari ia ka kushtuar karrierën e tij pavarësisë së Katalonjës, por qëndrimi kryesisht jotransigjent i partisë së tij ka shkaktuar konflikt me qeverinë qendrore të Spanjës

dhe partitë e tjera separatiste.

Ai ka drejtuar qeverinë rajonale të Katalonjës në vitin 2017, kur është mbajtur një referendum për pavarësinë pavarësisht një ndalimi gjyqësor.

Puigdemont, i cili ka udhëtuar nga Belgjika, përballet me akuzë për shpërdorim për rolin e tij në përpjekjen për ta ndarë Katalonjën nga pjesa tjetër e Spanjës.

Qeveria katalanase pretendon se rreth 2.3 milionë njerëz, rreth 43 për qind e votuesve me të drejtë vote, morën pjesë në referendum dhe se pak më shumë se 92 për qind votuan në favor të ndarjes nga Spanja.

Megjithatë, shumë njerëz që kundërshtojnë pavarësinë e bojkotuan votimin.

### Katalanasit votojnë në zgjedhje vendimtare rajonale

Parlamenti spanjoll ka

miratuar një ligj amnistie në maj për ata që janë përfshirë në secesio, por Gjykata e Lartë ka deklaruar muajin e kaluar se ai nuk zbatohet plotësisht për Puigdemont. Ai ka thënë se amnistia nuk vlen për ata që akuzohen për shpërdorim të fondeve publike, një akuzë e ngritur kundër kreut të Junts.

Kryeministri i qeverisë spanjolle, Pedro Sanchez, e ka pranuar ligjin e amnistisë në këmbim të mbështetjes së Junts për një qeveri të brishtë të pakicës në Parlamentin spanjoll. Kjo shkaktoi protesta të mëdha në rrugë të organizuara nga e djathta ekstreme kundër këtij hapi.

Sanchez përballet me kundërshtimin nga e djathta dhe nga partia e tij socialiste për një propozim për t’i lejuar Katalonjës kontrollin e plotë të taksave të mbledhura në rajon. /DW

## Bullgaria ndalon promovimin e LGBT+ në shkolla

**SOFIJE, 8 GUSHT** - Qeveria e Bullgarisë ka ndaluar mesazhet joheteroseksuale në shkolla, pas shembullit të Hungarisë, Polonisë dhe Sllovakisë. Sipas një ligji të ri, çdo promovim ose nxitje në lidhje me “orientimin seksual jotradicional” ose vetëvendosjen gjinore, që ndryshon nga gjinia e lindjes, ndalohet në parashkollorët dhe shkollat.

Kufizime të ngjashme ekzistojnë në vendet anëtare të BE-së, Hungari, Poloni dhe Sllovakia.

Jashtë BE-së, të drejtat e njerëzve LGBT+ (lesbikë, homoseksual, biseksual dhe transgjiner dhe komuniteti më i gjerë queer) përballen gjithashtu me kufizime të rënda, siç shihet në Rusi.

Amendamenti i ligjit, i cili është paraqitur nga partia pro ruse “Vazrazhdane”, ishte mbështetur nga anëtarë të parlamentit nga grupe të ndryshme politike, duke përfshirë aleancën e qendrës së djathtë Gerb-SDS, partinë populiste ITN, Partinë Socialiste

dhe, pjesërisht, partinë DPS, e cila përfaqëson interesat e pakicave turke dhe të tjera.

Megjithatë, aleanca liberal-konservatore PP-DB votoi kryesisht kundër amendamentit. Anëtarët dhe mbështetësit e komunitetit LGBT+ protestuan kundër amendamentit para ndërtesës së parlamentit në Sofje të mërkurën në mbremje. Ata shprehën refuzimin e tyre për të heshtur duke brohoritur dhe shfaqur pankarta me mesazhin “Mos përsërisni rrugën e Rusisë”.





KANDIDATI PËR KRYEMINISTËR I PDK-SË, BEDRI HAMZA, VIZITON SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)

## Hamza ia rihap dyert Kosovës në Shtëpinë e Bardhë

Në ditën që Departamenti Amerikan i Shtetit ka kritikuar ashpër Qeverinë e Kosovës, Shtëpia e Bardhë i ka hapur dyert për kandidatin e PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza. Ai ka njoftuar se të enjten është takuar me asistentin e posaçëm të presidentit amerikan Joe Biden. Hamza ka bërë me dije se gjatë takimit ka shpalosur planin e tij për Kosovën. Në këtë kontekst, Hamza ka thënë se ka marrë mbështetje të fuqishme nga ShBA-ja për Kosovën. Vizita e Hamzës në Shtëpinë e Bardhë ka ngjallur reagime në Kosovë. Njohës të rrethanave politike dhe politikanë të ndryshëm kanë thënë se një vizitë e tillë është e mirëseardhur për Kosovën



ambasadorin Michael Carpenter, është mirëpritur edhe nga PDK-ja. Ndërsa deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka vlerësuar se ky takim tregon se ura që e lidh Kosovën me ShBA-në është e fortë dhe e përjetshme. “Ura që lidh Kosovën me ShBA-në është e fortë dhe e përjetshme. ShBA-ja qëndron pranë nesh dhe mbështetn pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës”, ka shkruar Deliu-Kodra në “Facebook”.

### Hamza: Ura e Ibrit duhet të hapet, por jo duke i rrënuar urat me partnerët e Kosovës

Kandidati i PDK-së për kryeministër të Kosovës, Bedri Hamza, ka thënë se ura kryesore e Ibrit është tashmë e hapur për lëvizjen e lirë të qytetarëve, por duhet të hapet edhe për qarkullimin e automjeteve. “Megjithatë, mbeten vetëm edhe dy detaje që duhen adresuar: kur dhe si të hapet? Janë po këto ‘detaje’ që e mbajtën të mbyllur atë kaq gjatë. Dhe, po, janë po këto detaje të cilat i pranoi edhe kryeministri edhe ministri i tij i Brendshëm. Që të dy e pranuan se nuk dinë se si ta bëjnë një gjë të tillë dhe nuk e kanë as përkrahjen ndërkombëtare. Këtë e kanë ditur edhe përpara. E dinë edhe tash”, ka thënë ai për “Express”. Sipas Hamzës, sikurse edhe dhjetëra herë më herët, edhe këto ditë po dëshmojmë një ortek të manipulimeve të opinionit publik nga kjo qeveri në shkuarje. Ai ka shtuar se veprimet e tyre në veri s’janë tjetër veçse një farsë e paramenduar propagandistike. Hamza, i cili është duke qëndruar në ShBA, ka thënë se ura mbi Ibër duhet të hapet, mirëpo jo duke i rrënuar të gjitha urat e tjera me botën, me partnerët dhe me bashkëqytetarët tanë në veri.

EPOKA ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, është duke zhvilluar vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atje ai është takuar me zyrtarë amerikanë, me të cilët ka biseduar për qëllimet strategjike të Kosovës. Për realizimin e tyre, sipas tij, partneriteti me ShBA-në “është i rëndësishëm jetike”.

Hamza ka njoftuar se është takuar me asistentin e posaçëm të presidentit amerikan Joe Biden, ambasadorin Michael Carpenter, i cili njëherësh është drejtor i lartë për Evropë në Këshillin për Siguri Kombëtare, por dhe me drejtoreshën për Ballkanin dhe Evropën Qendrore, Kathleen Larkin. Sipas Hamzës, është koha të ketë përpzim në sigurimin e njohjeve nga pesë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, të ketë përpzim për sigurimin e udhërrëfyesit për anëtarësimin e Kosovës në Partneritetin për Paqe të NATO-s dhe “përfundimisht në NATO dhe Bashkim Evropian” që, sipas tij, janë qëllimet strategjike të vendit.

“Ne u pajtuam që tani është koha për progres në konsolidimin e Kosovës drejt njohjes nga pesë shtetet anëtare të BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur

pavarësinë e Kosovës, drejt sigurimit të udhërrëfyesit për anëtarësim të Kosovës në Partneritet për Paqe dhe përfundimisht në NATO e BE. Këto janë qëllimet strategjike për të cilat folëm gjerësisht. Unë prezantova shkurtimisht vizionin dhe planin tim që Kosova të lëvizë më shpejt përpara drejt zhvillimit ekonomik, rritjes së pagave në sektorin publik, investimeve kapitale dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve”, ka thënë Hamza.

### Vizita e Hamzës në ShBA nxit reagime në Kosovë

Në ditën që Departamenti Amerikan i Shtetit ka kritikuar ashpër Qeverinë e Kosovës,



Shtëpia e Bardhë ka hapur dyert për kandidatin e PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza. Takimi i këtij të fundit me zyrtarët e lartë amerikanë është parë si mesazh i qartë i ShBA-së për Kosovën.

Vizita e Hamzës në ShBA, e cila është duke ndodhur në kohën e izolimit të qeverisë Kurti nga aleatët, ka nxitur reagime të shumta në Kosovë.

Njohës të rrethanave politike dhe politikanë të ndryshëm kanë thënë se një vizitë e tillë është e mirëseardhur për Kosovën. Ish-zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, ka thënë se zyrtari i PDK-së i ka rihapur dyert e Shtëpisë së Bardhë për Kosovën. “Kryeministri i struktur n’shpi, ministrja e Jashtme po ashtu -

Bedri Hamza këto ditë rihapi dyert e Shtëpisë së Bardhë për Kosovën - po s’kishte si të jetë ndryshe. Kur për Kurtin ishte shtëpi e ngjyrave tjera, ai kurrë nuk e ka parë rëndësinë Amerikës për Kosovën dhe shqiptarët - ende s’dihet cili shtet është i rëndësishëm në kokën e Kurtit antiamerikan...”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.

Vizita e Hamzës është komentuar edhe nga analisti Afrim Kasolli. Ai ka thënë se kjo vizitë është një mesazh i qartë i Uashingtonit se ShBA-ja nuk është kundër Kosovës. “Madje këtë qëndrim zyrtarë amerikanë e kanë potencuar në vazhdimësi se ‘janë me popullin e Kosovës dhe do të jenë me të pavarësisht prej mosmarrëveshjeve që kanë me pushtetin aktual’”, ka shkruar Kasolli në “Facebook”, duke rikujtuar se kryeministri Albin Kurti nuk është duke realizuar vizita të rëndësishme.

“Takime të këtij niveli janë jetike për Kosovën, sidomos kur marrim parasysh faktin se vizita kryesore shtetërore e kryeministrit Kurti, mbetet ajo në Maqedoni të Veriut dhe takimi me liderin populist VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski, me qëllim qërimin e hesapeve të brendshme politike me presidenten Vjosa Osmani”, ka shkruar Kasolli.

Takimi i Hamzës me asistentin e posaçëm të presidentit Biden,

## Haradinaj bën thirrje për kujdes gjatë udhëtimeve: Serbia ka riaktualizuar përndjekjen e ish-pjesëtarëve të UÇK-së

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që kanë qenë pjesë e çlirimit të vendit, të bëjnë kujdes gjatë udhëtimeve sidomos nëpër Serbi. Ai ka thënë se Serbia ka arritur t’i shtrijë tentakulat e saj edhe në disa vende të rajonit si dhe është duke i shfrytëzuar përpjesëtimet e veta si anëtare e

Interpolit dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për ndjekje ligjore në vendet jashtë Kosovës.

“Të nderuar bashkëluftëtarë, Serbia në kuadër të luftës speciale kundër vendit tonë ka riaktualizuar përndjekjen e qytetarëve të Kosovës që kanë qenë pjesë e çlirimit të vendit, kryesisht ish-pjesëtarë të UÇK-së. Fatkeqësisht, Serbia ka arritur t’i shtrijë tentakulat e saj

edhe në disa vende të rajonit si dhe po i shfrytëzon përpjesëtimet e veta si anëtare e Interpolit dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, për ndjekje ligjore në vendet jashtë Kosovës. Një model i tillë ishte aplikuar me rastin e ndalimit tim në Francë dhe Slloveni. Prandaj ju këshilloj të bëni kujdes gjatë udhëtimeve tuaja”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.







## ShBA-ja: Kosova po vë në rrezik mundësitë që ne i kemi ndihmuar t'i krijojë

Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller, ka përsëritur se ShBA-ja është e shqetësuar me vendimet e fundit të Kosovës. Ai ka thënë se me këto veprime Kosova është duke i vënë në rrezik mundësitë që ia ka krijuar ShBA-ja. Në këtë kontekst, Miller në emër të ShBA-së e ka inkurajuar Qeverinë e Kosovës të kthehet “në angazhimin e ngushtë dhe konstruktiv” me ta, Bashkimin Evropian, NATO-n dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë

**WASHINGTON, 8 GUSHT** - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë thënë se me vendimet e vazhdueshme të pakoordinuara, Kosova po vë në rrezik mundësitë që Uashingtoni i ka ndihmuar që të krijojë.

Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Miller, në një konferencë për medie ka përsëritur se ShBA-ja është e shqetësuar me vendimet e fundit të Kosovës, kur u pyet nëse duhet të ketë pasoja për autoritetet në Kosovë pas mbylljes së disa objekteve të Postës së Serbisë në veri të vendit disa ditë më parë. “Ne besojmë se vënë në rrezik mundësitë që ne kemi ndihmuar që Kosova të krijojë. Nëse e shikoni që nga pavarësia e Kosovës, ShBA-ja fuqishëm ka

mbështetur integrimin e tyre të plotë në komunitetin ndërkombëtar si demokraci sovranë e multientike, por për të realizuar këtë vizion që ne ndajmë, ne kemi bashkëpunuar me udhëheqësit e njëpasnjëshëm të Kosovës në masat për ta fuqizuar paqen dhe prosperitetin në vend, duke avancuar Kosovën në rrugën euroatlantike”, ka thënë Miller. Në këtë kontekst, Miller në emër të ShBA-së e ka inkurajuar Qeverinë e Kosovës të kthehet “në angazhimin e ngushtë dhe konstruktiv” me ta, Bashkimin Evropian, NATO-n dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë.

Zëdhënësi i DASH-it ka thënë se këto qëndrime ia kanë shprehur edhe privatisht Qeverisë së

Kosovës, teksa ka theksuar se nuk dëshiron të spekulojë për veprimet në të ardhmen.

Më 5 gusht autoritetet në Kosovë kanë mbyllur nëntë objekte të Postës së Serbisë në veri të Kosovës – të banuar me shumicë serbe – vendim që u kritikua nga ShBA-ja dhe BE-ja. Vendimi është kritikuar edhe nga autoritetet në Serbi. Por, autoritetet në Kosovë kanë thënë se objektet e mbyllura nuk kishin licencë të punës. Ambasada Amerikane në Prishtinë ka reaguar po atë ditë, duke thënë se veprimet e pakoordinuara të Kosovës “përbalnin shtetasit e Kosovës dhe ushtarët e KFOR-it me rrezik të madh, nxisin përshkallëzim të panevojshëm të tensioneve rajonale, dhe

minojnë reputacionin e Kosovës si partnere e besueshme ndërkombëtare”.

ShBA-ja i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti, që t’u japë fund veprimeve të njëanshme dhe t’i kthehet angazhimit konstruktiv në dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë që ndërmjetësohet nga BE-ja. ShBA-ja, BE-ja edhe shtetet po kundërshtojnë hapjen e urës mbi lumin Ibër, që Qeveria e Kosovës po synon ta hapë për trafik.

Disa serbë protestuan të mërkurën në Mitrovicë të Veriut për ta kundërshtuar hapjen e urës mbi Ibër, që ndan Mitrovicën e Jugut, të banuar me shqiptarë, dhe atë të Veriut, të banuar me shumicë serbe. Qeveria e Kurtit në mes të korrikut ka njoftuar se synon ta hapë urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë. Megjithatë, vendet e Quintit – ShBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia, më 2 gusht kanë deklaruar se nuk e

mbështesin hapjen e urës në këtë moment.

Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka deklaruar se çdo vendim për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër duhet të merret në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky mision ka përsëritur se nuk do të ngurrojë t’i ndërmarrë “të gjitha masat e nevojshme” për t’i luftuar zhvillimet të cilat mund ta cenojnë sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Ushtarët italianë në kuadër të misionit të KFOR-it ndodhen në urën mbi lumin Ibër, ndërsa afër ndodhen edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Në periudhën pas luftës, ura mbi lumin Ibër ishte simbol i trazirave dhe barrikadave të ngritura nga serbët e Kosovës për t’i kundërshtuar përpjekjet e Kosovës për ta vendosur autoritetin në veri.

Ura, aktualisht, është e hapur vetëm për këmbësorë, edhe pse në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është rënë dakord që të hapet edhe për qarkullimin e automjeteve.



# Pak serbë në debatin për hapjen e urës së Ibrit

**MITROVICË, 8 GUSHT** - Disa qytetarë serbë kanë shprehur shqetësimet se hapja e urës mbi lumin Ibër mund t'i rrisë tensionet ndërkombëtare, teksa për këtë temë është zhvilluar një debat në mes të përfaqësuesve të qeverisë, atyre komunalë dhe qytetarëve në Mitrovicë të Veriut. Gjatë debatit, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe të policisë kanë ofruar garanci të sigurisë në rast të hapjes së urës për trafik – synim që po kundërshtohet nga serbët lokalë dhe bashkësia ndërkombëtare.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se shteti garanton që do të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët. “Po, shteti garanton që do të jetë në krye të detyrës që siguria publike në secilin cep të Kosovës të jetë në nivel që qytetarët të jenë të sigurt. Këtu ka një histori edhe të trazirave, kërcënimeve, edhe nxitjeve, por urat kanë një qëllim që ndërtohen: t'i bashkojnë pjesët që ndahen”, ka thënë ai, duke shtuar se hapja e urës nuk paraqet kërcënim për komunitetet.

Ndërsa zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë se ky institucion garanton për një “siguri shumë të madhe” nëse hapet ura.

Në debatin e organizuar në komunën e Mitrovicës së Veriut kishte një pjesëmarrje të vogël të



qytetarëve serbë dhe të pranishëm ishin asamblistë komunalë, përfaqësues të OSBE-së dhe medieve.

Ministri Krasniqi ka thënë se ura do të bëhet simbol i normalizimit të marrëdhënieve në Kosovë, që do të kontribuojë në lehtësimin e kontakteve të qytetarëve në jug dhe veri. “Tashmë është absurd vazhdimi i mbajtjes mbyllur të urës. Hapja nuk është dhe nuk do të jetë kundër askujt”, ka thënë ai në nisje të debatit.

Disa qytetarë serbë, të pranishëm në debat, kanë thënë se nuk është e nevojshme të hapet ura dhe mjafton që ajo të jetë e hapur për këmbësorë.

Ndërsa Jeta Tela nga Ministria e Punëve të Brendshme ka thënë

se ura do të duhej të ishte hapur për trafik shumë kohë më parë. “Besoj se jemi shumë vonë për hapjen e urës. Do të duhej të ishte hapur më herët. Sot ne do të duhej të flisnim për problemet kryesore që Mitrovica i ka si papunësia e problemet e tjera që i prekin drejtpërdrejt qytetarët, sepse u përmend disa herë që urat vetëm na bashkojnë. Kemi edhe garancinë që u dha nga policia për ta monitoruar situatën në rast të ndonjë shqetësimi”, ka thënë ajo.

Gjatë debatit, Tela ka thënë se MPB-ja është e përkushtuar ta rrisë bashkëpunimin në mes të policisë dhe komunitetit në këtë pjesë të Kosovës, duke theksuar se është e rëndësishme që pjesëtarët e komunitetit serb të

marrin pjesë edhe në forumet e sigurisë.

Serbët e pranishëm në këtë debat u ankuan për praninë e madhe të Policisë së Kosovës në veriun e banuar me shumicë serbe.

Ura mbi lumin Ibër ndan Mitrovicën e Jugut të banuar me shumicë shqiptare dhe Mitrovicën e Veriut me shumicë serbe dhe Qeveria e Kosovës, pavarësisht prej kundërshtimit të

bashkësisë ndërkombëtare, ka thënë se synon ta hapë atë për lëvizjen e automjeteve.

Qeveria e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në korrik ka bërë me dije synimin për hapjen e urës. Megjithatë, vendet e Quintit: ShBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia nuk janë duke e mbështetur hapjen e urës në këtë kohë.

## Testimi i Urës së Ibrit, Durmishi: Raporti del brenda dy-tri ditësh

Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka thënë se brenda dy-tre dite do të jetë gati raporti final, i cili do të tregojë nëse Ura e Ibrit është stabile për qarkullim të automjeteve.

Durmishi, i cili ka qëndruar në Mitrovicë, ka thënë se sot përfundon procesi i testimit të stabilitetit infrastrukturor të urës mbi lumin Ibër. Ai ka theksuar se në bazë të asaj që shihet, ura e Ibrit është ndër urat më stabile në Kosovë. “Sot jemi duke i bërë testimet e stabilitetit të urës, kemi filluar para dy dite, fillimisht matjet për të caktuar

gjeometrin e urës. Sepse ura nuk ka projekt. Sot ka metoda shumë të avancuara për ta matur stabilitetin e saj dhe këtë jemi duke e bërë. Gjatë ditës do ta përfundojmë testimin me ngarkesa dhe brenda dy tri-dite do ta kemi raportin final i cili do të na tregojë se ura është stabile apo nuk është. Në bazë të asaj që po e shohë, edhe duke qenë inxhinier me profesion, kjo është një ndër urat më stabile në Kosovë që kemi”, ka thënë Durmishi.

Zëvendësministri ka thënë se ende nuk kanë datë se kur do të hapet ura, por që është e sigurt se ajo do të hapet.

# BE-ja: Nëse situata nuk ndryshon, masat ndaj Kosovës mund të ashpërsohen

**BRUKSEL, 8 GUSHT** - Bashkimi Evropian (BE) shpreson që Kosova ta dëgjojë mesazhin e bllokut dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë sa iu përket vendimeve të fundit që janë cilësuar të njëanshme dhe të pakoordinuara.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se blloku e ka bërë të qartë qëndrimin sa i përket mbylljes së nëntë degëve të Postës së Serbisë në Kosovë nga autoritetet, por edhe synimit të Qeverisë së Kosovës që të hapë urën mbi lumin Ibër.

Ai ka thënë se masat ndëshkuese ndaj Kosovës, të vendosura në qershor të vitit të kaluar për shkak të rritjes së tensioneve në veri, janë ende në fuqi. “Në vend të hapave që do të çonin në uljen e tensioneve, janë ndërmarrë shumë e më shumë hapa dhe vendime të njëanshme që çojnë drejt përshkallëzimit. Atëbotë thamë që masat janë progresive, ato mund të ashpërsohen apo lehtësohen varësisht nga



zhvillimi i situatës. Kjo pjesë prek pjesën e parë të pyetjes, se çfarë do të bëjmë (pas vendimeve të fundit të autoriteteve në Kosovë). Pra, kemi masa në fuqi dhe këto masa mund të ashpërsohen nëse për një gjë të tillë pajtohen të gjithë aktorët e BE-së”, ka thënë Stano.

Përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, në qershor, përmes një raporti dërguar shteteve anëtare,

kishte rekomanduar heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës. Atëbotë burimet diplomatike i kanë thënë “Radios Evropa e Lirë” se në bllok nuk ka pajtim të plotë për heqjen e masave ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës. Por, si kompromis pritet që këto masa të hiqen pjesërisht dhe gradualisht.

Masat ndaj Kosovës ishin vendosur para një viti si përgjigje

ndaj përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës, kur kryetarët shqiptarë – të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët lokalë – nisën detyrën e tyre në komunat në veri.

Stano ka thënë se blloku evropian ai ka përcjellë qëndrimin Qeverisë së Kosovës në shumë mënyra dhe nuk është vetëm BE-ja që po kundërshton vendimet e fundit të autoriteteve të Kosovës.

“Praktikisht të gjithë partnerët ndërkombëtarë të Kosovës po i thonë administratës në Prishtinë të mos angazhohet në këtë seri hapash të pakoordinuar, të njëanshëm dhe negativë. Shpresoj që ata do ta dëgjojnë mesazhin tonë dhe të na ndalojnë që të shqyrtojmë se çfarë lloje masash ne do të vendosim në përgjigje (ndaj Kosovës) nëse situata nuk ndryshon”, ka thënë Stano.

Më 5 nëntor autoritetet në Kosovë mbyllën nëntë degë të Postës së Serbisë, pasi thanë se ato vepronin në veri të Kosovës pa licencë.

Përveç BE-së, edhe Shtetet e Bashkuara e kanë kritikuar këtë vendim. Uashingtoni ka thënë se veprimet e pakoordinuara të Kosovës “përballin shtetasit e Kosovës dhe ushtarët e KFOR-it me rrezik të madh, nxisin përshkallëzim të panevojshëm të tensioneve rajonale dhe minojnë reputacionin e Kosovës si partnere e besueshme ndërkombëtare”.



## Regjistrimi i diasporës vazhdon deri në fund të gushtit

PRISHTINË, 8 GUSHT - Diaspora e Kosovës ka mundësi edhe rreth 20 ditë të marrë pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë në Kosovë. Regjistrimi online i qytetarëve të Kosovës jashtë vendit

vazhdon deri më 31 gusht. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës i ka bërë thirrje diasporës ta shfrytëzojë të drejtën e saj dhe të marrë pjesë në këtë proces. "Regjistrimi i popullsisë është

një ndër proceset më të rëndësishme zhvillimore të vendit, kurse diaspora jonë është pjesë e pandashme e këtij procesi", ka theksuar Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës.



## Arrestohet edhe një person për mashtrime me patentë-shoferë në Pejë

PEJË, 8 GUSHT - Është arrestuar edhe një person i cili dyshohet se i përket grupit, i cili kishte bërë dallavere me patentë-shoferë në Pejë. Policia dhe Prokuroria Themelore e Pejës para dy javësh ka zhvilluar një aksion të gjerë në disa komuna si: Prishtinë, Fushë-Kosovë, Pejë, Deçan, Istog. Cak i këtij aksioni ishin 10 persona, shtatë prej të cilëve kishin përfunduar në pranga, derisa njëri ishte liruar për shkaqe shëndetësore. Ndërsa tre nga të dyshuarit nuk ishin hasur në shtëpitë e tyre gjatë kontrollit policor.

Lajmin e ka konfirmuar zëdhënësi i Prokurorisë Themelore të Pejës, Shkodran Nikçi. Ndaj pesë të dyshuarve Gjykata e Pejës ka caktuar një muaj paraburgim, ndërsa ndaj të dyshuarës T. Sh. është caktuar "Masa e arrestit shtëpiak".

Të prangosur nga ky aksion janë zyrtarë të Qendrës së Patentë-Shoferëve, por edhe pronarë të autoshkollës. Ata dyshohen për veprat penale "keqpërdorim i detyrës zyrtare", "marrja e ryshfetit", "marrja e ryshfetit në sektorin privat" dhe "legalizim i përmbajtjes së rreme".



## Komuna e Skenderajt vazhdon t'i mbështesë fermerët



SKENDERAJ, 8 GUSHT - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se të enjten janë nënshkruar kontratat me bujqit përfitues të makinave mbjellëse në kuadër të programit të përbashkët të bujqësisë në mes të kësaj komune dhe Islamic Relief Kosova.

Në ceremoninë e nënshkrimit të këtyre kontratave kanë marrë pjesë kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, drejtori i Islamic Relief Kosova, Mohamed Soliman, drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Behxhet

Maliqi dhe fermerët. Kryetari Nura, duke i përgëzuar bujqit, ka thënë se komuna e Skenderajt do të vazhdojë ta mbështesë sektorin e bujqësisë edhe nga buxheti i komunës, por edhe me anë të donatorëve të ndryshëm.

Edhe drejtori i Islamic Relief Kosova, Mohamed Soliman, i ka përgëzuar fermerët përfitues të makinave mbjellëse, ndërkohë e ka falënderuar kryetarin Nura për bashkëpunim të vazhdueshëm.

## Bulliqi mbajti takim me mërgatën

Podujevë, 8 gusht - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka qenë nikoqir i takimit me mërgatën, i cili është mbajtur në oborrin e Galerisë së Arteve në Podujevë në kuadër të Manifestimit "Ditët e Diasporës".

Kryetari Bulliqi në një fjalë rasti i ka falënderuar bashkatdhetarët për investimet që po i bëjnë në vazhdimësi në vendlindje. Ai i ka informuar ata për

mundësinë që komuna e Podujevës është duke ofruar për investitorët, duke përmendur zonën ekonomike si një mundësi e jashtëzakonshme për ata që duan të investojnë në Podujevë.

Në takimin me mërgatën kanë marrë pjesë edhe ministra, deputetë dhe zyrtarë të tjerë nga niveli qendror e lokal.

Një fjalë rasti mbajti edhe zëvendëskryeministrja Donika

Gërvalla, njëherësh ministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, e cila i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi bashkatdhetarët që asnjëherë nuk e harruan atdheun e tyre.

Më pas është shfaqur edhe një dokumentar kushtuar rajonit të Llapit.

Për organizimin e këtij takimi ka ndihmuar edhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës.





## Më 12 gusht shqiptarët protestojnë në Bujanoc

**PRESHEVË, 8 GUSHT** - Kryetarja e komunës së Preshevës, Ardita Sinani, ka njoftuar për një protestë që do të mbahet më 12 gusht në qytetin e Bujanocit. Ajo ka bërë me dije se protesta do të fillojë nga ora 12:00. Sinani ka thënë se shqiptarëve janë duke i mohuar të drejtat elementare

të njeriut pasi Qeveria e Serbisë, edhe pas përpjekjeve dhe angazhimit institucional, nuk është duke i përfillur kërkesat e tyre. "Prandaj na duhet çdo formë që për synim ka sensibilizimin e çështjes sonë. Për pozitën tonë, si pakica më e shkelur, rrugës institucionale

është koha t'ia bashkëngjijm edhe ngritjen e zërit në rrugë përmes protestës. Të gjithë bashkë, pa dallim. Si shqiptarë të diskriminuar takohemi më 12 gusht, ditë e hënë, me fillim nga ora 12:00 në Sheshin e Bujanocit", ka shkruar Sinani në "Facebook".



## Zgjatet afati për konvertimin e patentë-shoferëve

**PRISHTINË, 8 GUSHT** - Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka njoftuar të enjten se është zgjatur afati për aplikim të pjesëtarëve të komunitetit serb për të konvertuar patentë-shoferët e tyre të lëshuar nga institucionet serbe në ato të Kosovës. Afati është zgjatur deri më 23 gusht, pasi ministri Sveçla ka thënë se ka interesim të madh për aplikim. Sipas Sveçlës, deri më tani 5 588 qytetarë të komunitetit serb kanë aplikuar për t'i konvertuar këto dokumente dhe vetëm gjatë ditës së djeshme kanë qenë 273 aplikime. "5 588 qytetarë nga radhët e komunitetit serb kanë aplikuar për konvertimin e patentshoferëve nga ata të lëshuar nga institucionet ilegale serbe në patentshoferë zyrtar të Republikës së Kosovës. Ky proces i cili është mundësuar në të gjitha qendrat e Agjencisë së Regjistrimit Civil në Republikën e Kosovës ka vijuar pa asnjë incident të vetëm. Bazuar në kërkesat e shumta të qytetarëve për aplikim të pajisjes me patentshoferë të Republikës së Kosovës, ku vetëm dje kemi pasur 273 sosh, si dhe kërkesën për zgjatje të afatit për aplikim i cili sipas vendimit tonë përfundon nesër, kam marrë në konsideratë ato me ç'rast afati për konvertim do të zgjatet deri me 23 gusht 2024. Pas kësaj date, për të gjithë ata që nuk konvertojnë patentshoferët, do të veprohet sipas legjislacionit përkatës në fuqi. I falënderoj të gjithë qytetarët e komunitetit serb që kanë kryer obligimin e tyre për konvertim të patentshoferit dhe i ftoj të gjithë ata që nuk e kanë kryer këtë proces që të respektojnë afatet në



fuqi", ka shkruar Sveçla në "Facebook".

Kosova nuk njuh dokumentet e lëshuara nga Serbia për qytetarët serbë në Kosovë.

Më herët, Policia e Kosovës ka thënë se pasi të kalojë afati për konvertimin e patentë shoferëve, të gjithë drejtuesit e automjeteve që kanë këto dokumente të lëshuara nga Serbia, do të konsiderohen se janë duke e

drejtuar veturën pa patentë shoferë.

Nga policia kanë thënë se në përputhje me vendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, ndaj këtyre individëve do të shqiptohen gjoba me mundësi të konfiskimit të automjeteve.

Shuma e gjobave, sipas ligjit, është nga 500 deri në 1 500 euro. Në fillim të majit Qeveria e Kosovës

kishte marrë vendim për pajisjen e serbëve në Kosovë me patentë shoferë RKS - Republika e Kosovës. Vendimi hyri në fuqi më 9 maj dhe ishte paraparë të përfundonte më 9 gusht.

Procesit të pajisjes me patentë shofer të Kosovës i ka paraprirë procesi i reregjistrimit të veturave me targa serbe në targa RKS (Republika e Kosovës), sidomos për ato me regjistrimin KM

(Mitrovica e Kosovës). Procesi i reregjistrimit të automjeteve, i cili ka zgjatur prej fundit të vitit 2022 deri në mesin e dhjetor të vitit 2023, ka nxitur një sërë krizash në veri të Kosovës: daljen e serbëve nga institucionet e Kosovës, protesta, barrkada, bojkot të zgjedhjeve, dhe gjithçka kulmoi me një sulm të armatosur të një grupi të organizuar të serbëve kundër Policisë së Kosovës.

## Oficerët e FSK-së përfundojnë me sukses trajnimin në ShBA për artileri

**PRISHTINË, 8 GUSHT** - Nëntogerët Labinot Osaj, Shpëtim Hasani dhe Arian Karaxha kanë përfunduar me sukses kursin bazik të udhëheqjes për artileri fushore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA).

Trajnimi ka pasur për qëllim përgatitjen e ushtarakëve për udhëheqës të togut të artilerisë, oficer të mbështetjes me zjarr si dhe

oficer të drejtimit të zjarrit. "Si udhëheqës të Togut të Artilerisë pjesëmarrësit marrin njohuri praktike për pajisjen 'Howitzer' amerikan M777 (155mm), M109 (155mm), dhe M119 (105mm). Në modulën e mbështetjes me zjarr, përgatiten ushtarakët për specifikat e 'Howitzereve', planifikim dhe thirrje të mbështetjes me zjarr, vëzhgimin e zjarrit si dhe

llojet e mbështetjes që ofron artileria fushore si dhe në fushën e Qendrës së Drejtimit të Zjarrit trajnohen për kalkulimin dhe faktorë të ndryshëm që ndikojnë në një qitje sa më precize", ka njoftuar FSK-ja.

Për shkak të sukseseve të treguara në trajnim, nëntogeri Arian Karaxha ka marrë çmimin "Distinguished International Honor Graduate".





## Rizvanolli: Koha që marrëdhëniet me Italinë t'i shndërrojmë edhe në bashkëpunim ekonomik

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, është takuar me ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu.

Rizvanolli ka thënë se është koha që marrëdhëniet e mira bilaterale me Italinë të shndërrohen edhe në

bashkëpunim ekonomik, veçanërisht përmes investimeve të kompanive italiane në Kosovë. "Kosova dhe Italia kanë marrëdhënie të mira bilaterale. Është koha që këto marrëdhënie t'i shndërrojmë edhe në bashkëpunim ekonomik, veçanërisht përmes

investimeve të kompanive italiane në Kosovë. Me ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, diskutuam për këtë bashkëpunim ekonomik, në veçanti për investimet në kapacitete të reja gjeneruese të erës", ka shkruar Rizvanolli në "Facebook".



## Përurohet rruga '17 Shkurti' në Godanc të Shtimes në vlerë prej 570 mijë eurosh

SHTIME, 8 GUSHT - Është përuarur të enjten rruga "17 Shkurti" në Godanc të Shtimes. Në përuarimin e kësaj rrugë kanë marrë pjesë ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe kryetari i komunës së Shtimes, Qemajl Aliu.

Ministri Aliu ka thënë se ky investim ka rëndësi të madhe për shkak se lidh fshatrat e pjesës lindore të Malësisë, duke u krijuar mundësi të lidhen drejtpërdrejt në magjistrale pa pasur nevojë ta ngarkojnë qendrën e qytetit.

Ndërsa kryetari i Shtimes, Qemajl Aliu, ka thënë se kjo rrugë është e gjatë 2.8 kilometra. Ai ka thënë se kjo rrugë është një nga akset me strategjike që do t'i kontribuojë zhvillimit të gjithëmbarshtëm të

kësaj komune. "Është rrugë që është financuar përmes memorandumit nga Ministria e Ambientit dhe Infrastrukturës së bashku me komunën e Shtimes. Rruga është 2.8 kilometra. 1.3 kilometra e shoqërojnë trotuari dhe ndriçimi. Kjo rrugë e ka rëndësinë e jashtëzakonshme për komunën e Shtimes sepse e mbyll segmentin e fundit që lidh fshatrat. Ky është krahu i majtë i aksit të zhvillimit të komunës tonë. Këto fshatra, duke filluar nga kryqi i Komoranit e deri në Pjetërshicë, lidhen me këtë segment. Ky do të jetë aks i zhvillimit për komunën tonë. Është një nga akset më strategjike që do t'i kontribuojë zhvillimit të gjithëmbarshtëm të komunës. Ky projekt ka kushtuar 570 mijë euro", ka thënë ai.



## 'Hajnat e KEK-ut...', disa banorë të Shipitullës vendosin pankarta në selinë qendrore të korporatës

PRISHTINË, 8 GUSHT - Përfaqësues të fshatit Shipitullë të Obiliqit, në shenjë proteste për shpronësimet, kanë vendosur pankarta me ngjitës pranë Prokurorisë Speciale, Ministrisë së Ekonomisë dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në Prishtinë. Në këto letra janë të listuara emrat, personat të cilët janë duke u

akuzuar për vjedhje e tentim-vjedhje dhe afere korruptive të miliona eurove.

Këta banorë nuk kanë folur para medieve.

Tash e disa herë banorët e Shipitullës kanë shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me shpronësimet, për çfarë kanë kërkuar që ato të bëhen nga fillimi.

## Më 15 gusht mbahet ankandi i dhjetë i letrave me vlerë për vitin 2024

PRISHTINË, 8 GUSHT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 15 gusht 2024 do të mbahet ankandi i dhjetë për vitin 2024. Në këtë ankand, sipas kësaj ministre, do të emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 10 milionë

eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garantitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", ka njoftuar Ministria e

Financave, Punës dhe Transfereve.

Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ministria ka ftuar të interesuarit që ta kontaktojnë ndonjëherë nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës.





# Pse Ukraina vendosi të sulmojë Rusinë?!

Ukraina nisi një sulm të befasishtëm tokësor ndaj Rusisë në një nga inkursionet më të mëdha të Ukrainës në territorin rus në dy vite lufte.

Por shumë analistë, megjithatë, kanë ngritur pikëpyetje në lidhje me objektivin e sulmit pasi Kievi vendosi të hapë një front të ri kur forcat e tij po humbasin vazhdimisht terren në rajonin lindor të Ukrainës, Donetsk.

Një nga çështjet më të mëdha në fushën e betejës ukrainase është fuqia ushtarake. Rusia ka më shumë trupa dhe po i afrohet qytetit lindor të Ukrainës, Pokrovsk.

Kështu, vendosja e qindra ushtarëve ukrainas në tokën ruse interpretohet si një strategji e diskutueshme nga shumë analistë ushtarakë, me disa që nuk janë dakord.

“Nuk ishte rastësi,” tha eksperti analist i luftës Kostyantyn Mashovets në një postim në

Facebook. “Është qartazi pjesë e një plani specifik”.

Mykhaylo Zhyrokhov, një analist ushtarak, është gjithashtu dakord, pasi ai tha se Rusia është detyruar të ridislokojë disa trupa atje nga vija e frontit në Ukrainën lindore.

Ky sulm ka shumë pak gjasa që të synojë marrjen e territorit rus nga Ukraina, por nëse tërheqja e forcave ruse ishte një qëllim, u arrit shpejt.

Recently Spotted Asteroid Set for Near Miss With Earth

Keep Watching

Ky sulm mund të luajë gjithashtu një rol në vendimin për të pushtuar Ukrainën nga toka. Rusia ka nisur një ofensivë të madhe ndërkuftare në rajonin verilindor të Kharkiv të Ukrainës. Përparimi duket se është ngadalësuar pasi SHBA i dha Ukrainës lejen për të përdorur armët amerikane kundër objektivave brenda Rusisë.



Ukraina kishte frikë se një sulm i ngjashëm rus ishte i pashmangshëm në rajonin verior Sumy në tre muajt e ardhshëm.

Duke pasur parasysht

shqetësimet perëndimore për një përshkallëzim të luftës, ka të ngjarë që të jetë dhënë një lloj leje për një operacion të kësaj përmasash në tokën ruse.

Zyrtarët e lartë ukrainas nuk kanë folur shumë për këtë sulm. E pyetur nga BBC, zyra e presidentit, Volodymyr Zelensky, u përgjigj: “Nuk ka koment”.

Ndërsa inkursione të ngjashme kanë ndodhur në të kaluarën, kjo është hera e parë që forcat e rregullta ukrainase kryejnë një sulm të kësaj shkalle.

Përkundrazi, nga pala ruse komentet janë më shumë. Kanalet ushtarake ruse transmetuan sulmin, i cili përfshinte qindra ushtarë dhe disa sulme me raketa dhe dron. Zyrtarët lokalë dhanë menjëherë urdhëra për evakuim. Zonat fqinje kërkuan të strehonin ata që u detyruan të linin shtëpitë e tyre dhe shpallën gjendjen e jashtëzakonshme.

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë madje pranoi se trupat ishin

vendosur në një qytet në rajonin e Kurskut.

Në të njëjtën kohë, Vladimir Putin u informua publikisht nga shefat e tij të sigurisë me zëdhënësin e Ministrisë së Jashtme duke e quajtur sulmin “barbar” dhe “terrorist”.

Sulmi tashmë shihet nga Kremli si provë se pse duhet të vazhdojë të zhvillojë luftën e tij, një pushtim që ai ende e karakterizon si “mbrojtës”.

“Ka më shumë pyetje sesa përgjigje për ngjarjet në rajonin e Kurskut,” tha analisti ushtarak Mykhaylo Zhyrokhov.

Është e qartë se për Ukrainën, nëse ndalon apo edhe e pengon Rusinë të nisë një ofensivë të madhe në veriun e saj, atëherë ky operacion ia vlen.

“Sa më shumë presion i bëhet agresorit që bën luftë në Ukrainë”, tha Presidenti Zelensky në fjalimin e tij të pasdites, “aq më afër është paqja”.



## Hyrja e trupave ukrainase në Rusi, Moska kërkon hakmarrje

Gjendja e emergjencës u shpall në rajonin e Kursk në Rusi, teksa një sulm i rrallë ndërkuftar nga trupat ukrainase, vijoi edhe përgjatë së mërkurës.

Gubernatori në detyrë rajonal Alexei Smirnov, tha se lëvizja ishte e nevojshme për të eliminuar pasojat e hyrjes së forcave armike në rajon. Autoritetet ruse thanë se të paktën 5 civilë ishin vrarë dhe 31 të tjerë ishin plagosur 3 prej të cilëve fëmijë, që prej nisjes së inkursionit. Putin e cilësoi mësymjen si një akt të rëndë provokues.

Mëngjesin e së martës, rreth 1

mijë trupa ukrainas, bashkë me 11 tanke e më shumë se 20 mjete të tjera të blinduara luftarake, hynë në Rusi, pranë qytetës së Sudzha. Luftime u raportuan në një numër fshatrash, me autoritetet lokale që u bënë thirrje banorëve të kufizojnë lëvizjet, ndërsa të gjitha eventet publike u anuluan.

Sirenat e alarmit për sulme ajrore u aktivizuan në Kursk dhe xhirime të postuara online treguan avionët e luftës që fluturonin ulët mbi rajon. Kolona tymi u panë të ngriheshin në disa zona. Mijëra të u evakuan nga zonat kufitare dhe ekipe



mjekësore u dërguan atje, nga qytete të tjera. Inkursionet ukrainase në territorin rus kanë qenë ekstremist të rralla që kur Moska nisi luftën e plotë në



shkurt të 2022-shtit.

Mbrëmjen e së mërkurës, parlamentari ukrainas, Oleksiy Honcharenko njoftoi se ushtria e Kievit kishte marrë kontrollin e

pikës së shpërndarjes së gazit në Sudzha, e cila luan rol të rëndësishëm në kalimin e gazit natyror nga Rusia në be përmes Ukrainës.

Përgjigja e Rusisë ndaj inkursionit do të jetë një prej testeve të parë të mëdha të ministrit të ri të mbrojtjes, Andrei Belousov që prej zëvendësimit të Sergei Shoigu... ish-presidenti dhe zvkryetari i këshillit të sigurisë në Rusi, Dmitri Medvedev ka kërkuar që Moska të kundërpërgjigjet duke çuar trupat më tej në Ukrainë; në Odesa, Kharkiv, në Kiev e më tej.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Ekipi i xhudos së Kosovës nderon dëshmorët dhe martirët e kombit në Prekaz

### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 8 GUSHT** - Ekipi olimpik i xhudos së Kosovës, i drejtuar nga trajneri Driton Kuka, e ka vizituar kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Trajneri Kuka i ka publikuar në rrjetet sociale dy fotografi, ku shihet duke vendosur lule te varri i heroit kombëtar Adem Jashari, ndërsa ekipi olimpik u përul përpara dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Krahas Kukës, në këtë vizitë të pranishëm ishin edhe trajnerja dhe kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi, fituesja e dy medaljeve olimpikë, Distria Krasniqi dhe medalistja më e re olimpikë e Kosovës, Laura Fazliu, si dhe xhudisti Akil Gjakova dhe trajneri Fatos Tabaku. Ndërsa për ekipin e xhudos ka shkruar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili u shpreh i lumtur dhe krenar që është miku i tyre dhe që nderojnë Kosovën botërisht dhe u shërbejnë edhe

Forcave të Armatosura të Shqipërisë. “I lumtur dhe krenar që jam miku juaj, e që ju nderoni Kosovën botërisht dhe u shërbeni edhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë”, ka shkruar Edi Rama në “Facebook”.

Ekipi olimpik i Kosovës arriti të fitojë dy medalje olimpikë në “Paris 2024”. Kampionia olimpikë nga “Tokio 2020”, Distria Krasniqi, fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë deri në 52 kilogramë në xhudo, ndërsa Laura Fazliu fitoi medaljen e bronzit në debutimin e saj.

**‘New York Times’: Në mesin e tre shteteve me më së shumti medalje për nga numri i garuesve**

Kosova ka arritur suksesshëm të garojë në Lojërat Olimpikë “Paris 2024”. Vendi u përfaqësua nga vetëm nëntë sportistë, por i rrëmbeu dy medalje në këtë Olimpiadë. E këto dy medalje e bëjnë Kosovën në mesin e tri



shteteve që udhëheqin listën e medaljeve për numër të sportistëve pjesëmarrës. Komiteti Olimpik i Kosovës ka

njoftuar se vlerësimin e ka bërë gazeta e njohur “New York Times”, e cila në krye të shkrimit ka vendosur foton e medalistes

sonë të argjendtë, Distria Krasniqi. Dy vendet e tjera në top treshe janë St. Lusja dhe Dominika.

## FBK-ja nderon me mirënjohje Klubin 3x3 Prishtina



**PRISHTINË, 8 GUSHT** - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, dhe sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku, kanë pritur në takim përfaqësuesit e Klubit 3x3 Prishtina, Fikret Shatri dhe Fisnik Juniku. Në këtë takim u nderua Klubi 3x3 Prishtina me një mirënjohje të veçantë nga kryetari Fetahu, si shenjë falënderimi për angazhimin dhe organizimin e suksesshëm të eventeve të basketbollit 3x3, duke promovuar këtë kategori të rëndësishme të sportit. Gjatë

diskutimeve u theksua rëndësia e vazhdimin të organizimeve të ngjashme jo vetëm për pjesën e mbetur të këtij viti, por edhe për vitet e ardhshme. FBK-ja ritheksoi përkushtimin e saj për të mbështetur çdo iniciativë që ndihmon në promovimin dhe zhvillimin e basketbollit në Kosovë. Kujtojmë që këtë verë Kosova ka qenë nikoqire e tri ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare të basketbollit 3x3: FIBA 3X3 Europe Cup Qualifier, FIBA 3X3 Women's Series dhe FIBA 3X3 Challenger

Prishtina, dy të fundit të organizuar nga 3x3 Prishtina në përkrahje nga FBK-ja. Këto organizime kanë shërbyer si dëshmi e kapaciteteve të Kosovës për të pritur dhe organizuar evenimente të këtij niveli, duke ngritur profilin e basketbollit 3x3 në vendin tonë. FBK-ja mbetet e angazhuar për përkrahjen e aktiviteteve që rrisin popullaritetin dhe cilësinë e basketbollit në Kosovë, duke siguruar se çdo hap në këtë drejtim do ta ketë mbështetjen e saj të plotë.

## U mbajt seminari për trajnerë me instrukturin Klaus Stark

**PRISHTINË, 8 GUSHT** - Është mbajtur të enjten seminari njëditor për trajnerët e Superligës dhe Ligës së Parë, në të dy konkurrencat, me temë “Sistemet e lojës (përparësitë dhe mangësitë) dhe aplikimi i tyre në praktikë”, me ligjërues instrukturin gjerman Klaus Stark. I organizuar nga Shoqata e Trajnerëve të Futbollit dhe përkrahur nga FFK-ja, ky seminar, i cili u shërben trajnerëve për t'i përditësuar njohuritë e tyre teorike dhe praktike në lojën e futbollit, u

mbajt në Kampin Nacional në Hajval derisa ishin të pranishëm rreth 50 pjesëmarrës. Këta të fundit e vlerësuan përvojën e instrukturit gjerman dhe ligjëratën e tij, derisa pohuan se gjithmonë ka vend për të mësuar gjëra të reja. Në anën tjetër, instruktori gjerman Stark lavdëroi interesimin dhe përkushtimin e trajnerëve kosovarë për të mësuar dhe për të ndihmuar në zhvillimin e mirë dhe të duhur të futbollit në vend por nuk e mohoi, siç tha ai, faktin

se kanë nevojë për më shumë përvojë. Ndërsa anëtar i Bordit të Shoqatës së Trajnerëve, Ajet Shosholli, ka thënë se këto seminare organizohen për të mirën e trajnerëve, të cilëve u ndihmon të jenë në hap me zhvillimin e shpejtë të futbollit. Me këtë rast, ai i ftoi të marrin pjesë në këto seminare edhe ata që sot munguan. Pas pjesës teorike, pjesëmarrësit vazhduan me pjesën praktike, e cila u aplikua me instruksionet e ekspertit gjerman Klaus Stark.





## Nadali tërhiqet edhe nga US Open

MADRID, 8 GUSHT - Tenisti spanjoll Rafael Nadal ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në grand slam e US Open (26 gusht-8 shtator). Vendimi është marrë një javë pas eliminimit të tij nga Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Nadal ka konfirmuar se do të

marrë pjesë në turneun "show" të Laver Cup, në fund të shtatorit, por jo në US Open. Spanjollit është 4 herë fitues i këtij turneu, më i fundit në vitin 2019 dhe që nga ai vit ka marrë pjesë vetëm një herë. "Përshëndetje të gjithëve! Ju shkruaj sot për

t'ju bërë të ditur se kam vendosur të mos konkurroj në US Open të këtij viti, një vend ku kam kujtime të mrekullueshme", ka shkruar Nadal në rrjetet sociale. "Do të më mungojnë ato seanca elektrike dhe ato ndeshje speciale të natës në Nju-Jork,

në Ashe. Nuk mendoj se do të mund të jap 100 % këtë herë. Faleminderit të gjithë fansave të mi në ShBA", ka shtuar spanjollit. "Do t'ju mungoj të gjithëve dhe do t'ju shoh një herë tjetër. Fat të mirë për të gjithë për US Open, gjithmonë një turne i



mahnitshëm! Eventi im i radhës do të jetë Laver Cup në Berlin", ka deklaruar Nadal.

## Lewandowski: I lumtur që po punoj sërish me Flick, ai ka ADN e lojës së Barcelonës

BARCELONË, 8 GUSHT - Robert Lewandowski (35 vjeç) shënoi golin e tij të parë këtë (para) sezon kundër Milanit, pastaj komplettoi dopietën personale në barazimin 2-2 të kohës së rregullt. Sulmuesi polak ishte, së bashku me Christensen, ndërkombëtar i parë që iu bashkua dinamikës së Barçës, pas fazës së grupeve të Evropianit. Në dy ndeshjet e para të turneut amerikan nuk e kishte gjetur rrjetën kundër Manchester City dhe Real Madridit. Nuk iu desh shumë kohë për ta bërë këtë kundër Milanit, kur arriti ta mposhtë Torrianin me një goditje të shkëlqyer nga buza e zonës. Në pjesën e dytë ai barazoi rezultatin, pasi mori një asistim të shkëlqyer nga Pau Víctor. Pas këtyre dy golave dhe me MVP e ndeshjes nën emrin e tij, Lewandowski foli për "Bild". Aty



rishikoi se si po shkojnë javët e para me Flick, dikë që është i lumtur ta takojë sërish: "Jam shumë i lumtur dhe i kënaqur që punoj me të përsëri. Me Hansi mendoj se do të kemi një sezon të mrekullueshëm, do të përfundojmë duke pasur një trofe në duart tona". Polaku theksoi se nuk duhet të jenë

konformistë, por të kërkojnë gjithmonë më shumë, siç thuhet në filozofinë e klubit blaugrana: "Ne nuk duhet të ndalojmë së sulmuari pas fitores 1-0, por të vazhdojmë të ofrojmë spektakël. Kjo është ADN-ja e këtij klubi. Hansi përshtatet shumë mirë me këtë ADN përmes lojës së tij sulmuese".

## Leclerc: S'do të kem mëshirë për Hamiltonin kur të jemi bashkë

SHTUTTGART, 8 GUSHT - Me ardhjen e Lewis Hamiltonit dhe rikonfirmimin e Charles Leclerc, sezonin e ardhshëm Ferrari do të ketë padyshim një nga çiftet më të mira të pilotëve në start. Gjithsesi, ka kuriozitet për të kuptuar se cili do të jetë raportit mes dy pilotëve si në kualifikim ashtu edhe në garë. Charles Leclerc e ka gjetur veten duke iu përgjigjur shpesh pyetjeve rreth partnerit të tij të ardhshëm. "Kur isha fëmijë, duke qenë në pistat go-kart çdo fundjavë, ishte e vështirë për mua ta ndiqja sezonin e Formula 1. Gjithsesi, Lewis ishte padyshim një nga ata që admiroja", ka thënë Leclerc. Monogasku më pas shpjegon se ai e pret duelin brenda familjes kundër 7 herë kampionit të botës. "Do të jetë një mundësi e jashtëzakonshme edhe për mua, pasi do të jem në gjendje të tregoj se çfarë jam në gjendje për të bërë", u shpreh Charles Leclerc.



"Nëse do të jem i butë me të? Sigurisht që jo. Kur vendos helmetën time në kokë, asgjë nga këto miqësi nuk ekziston më në

pistë. Unë do të fokusohem vetëm në performancat e mia pasi të nis garën. Kjo vlen edhe për Hamiltonin", ka shtuar Leclerc.

### SHKURT

#### Granada refuzon ofertën e Vallecános për Uzunin

E ardhmja e Myrto Uzunit vazhdon të jetë e paqartë nëse do të mbetet pjesë e Granadas apo do të largohet. Sulmuesi shqiptar mund të jetë pranë lamtumirës së Granadës pas rënies së ekipit andaluzian në La Liga 2 të Spanjës. Pavarësisht se ka qenë një nga figurat më të spikatura të klubit, e ardhmja e tij duket të jetë në ajër.

Rayo Vallecano, një nga skuadrat e LA Ligas që kërkon ta forcojë repartin ofensiv, e ka bërë shqiptarin prioritet. Oferta fillestare e skuadrës madrilene arrin në katër milionë euro, por Granada konsideron se kjo shifër është e pamjaftueshme për ta lënë yllin të largohet. Megjithatë, kjo ofertë është konsideruar e ulët nga Granada që e ka refuzuar atë. Klubi andaluzian po kërkon rreth tetë milionë euro që ta lë shqiptarin të largohet, pasi atë e konsideron shumë të rëndësishëm.

29-vjeçari sezonin e kaluar kontribuoi me 11 gola në La Liga, derisa dy vjet më parë realizoi 23 gola për Granadan.

#### ShBA-ja po prin bindshëm në Lojëra Olimpikë 'Paris 2024'

Paraqitja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" lirisht mund të quhet tjetër nivel. Ekipi olimpik i ShBA-së po prin bindshëm me numrin e medaljeve të fituara. Aktualisht i ka të fituara 94 medalje, prej tyre 27 të arta, 35 të argjendta dhe 32 të bronzta. Pas saj renditet Kina, me 65 derisa e treta është Australia me 42. Kosova aktualisht renditet e 61-ta me dy medalje. Një e argjendte dhe një e bronzte, është rezultati i paraqitjes së sportistëve tanë në kryeqendrën franceze. Medaljet u rrëmbyen nga xhudistet Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu. Lojërat Olimpikë kanë nisur më 26 korrik dhe do të zgjasin deri më 11 gusht.

#### Reus transferohet te LA Galaxy

Marco Reus është transferuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veterani gjerman, i cili u largua nga Borussia Dortmund pas 12 vitesh, do të jetë lojtari më i ri i LA Galaxy, sipas gazetarit të njohur sportiv, Fabrizioo Romano. Reus do të nënshkruajë kontratë njëvjeçare, me opsion zgjatjen edhe për 1 vit tjetër. 35-vjeçari do të udhëtojë ditët në vijim në ShBA për të kryer testet mjekësore e më pas për ta firmosur kontratën. "LA Galaxy ra dakord për të nënshkruar me Marco Reus si agjent të lirë, tanimë e konfirmuar. Pas marrëveshjes verbale të arritur në korrik, detajet tashmë janë sqaruar mes të gjitha palëve. Kontrata do të jetë deri në dhjetor 2025, me opsion zgjatjen edhe për 1 vit tjetër. Reus tani planifikon të udhëtojë në ShBA në ditët në vijim pasi do të jetë gati për testet mjekësore dhe nënshkrimin e kontratës", raporton Romano në "Facebook".

## Fenerbahçe ofron 20 milionë euro për Gundogan

Fenerbahçe do që ta ketë në ekip sezonin e ardhshëm mesfushorin e Barcelonës, Ilkay Gundogan. Më saktë kjo është një dëshirë e trajnerit Jose Mourinho dhe klubi turk është i gatshëm t'i plotësojë madje, sipas raporteve të

medieve spanjolle, Fenerbahçe ka ofruar 20 milionë euro për ta blerë kartonin e 33-vjeçarit. Duke pasur parasysh nevojën e klubit katalanas për të mbledhur sa më shumë para për t'i respektuar kufizimet e

"fair-play financiar", kjo lëvizje nuk duket aq e pamundur. Gundogan nga ana tjetër ka marrëdhënie të tensionuara edhe me disa shokë të skuadrës dhe është dashur të ndërhyjnë presidenti Laporta dhe drejtori sportiv Deco për

t'i shmangur "shkëndijat" në dhomat e zveshjes. Një ambient "toksik" që mund ta drejtojë mesfushorin për kalimin te Fenerbahçe, me klubin turk që është gati t'i ofrojë klubit katalanas 20 milionë euro. Megjithatë,

drejtori sportiv Deco dhe presidenti Laporta do të donin të merrnin më shumë para, pasi për Gundogan ka oferta edhe nga Arabia Saudite që do të ishin të gatshëm ta paguanin dyfishin e shumës së ofruar nga Fenerbahçe.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Trinity Logistics" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811919151 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Trinity Logistics" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811919151 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Trinity Logistics" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811919151 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Kosherja" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811316878 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Kosherja" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811316878 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Kosherja" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811316878the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Enisi Trade" SH.P.K. me seli në Viti, pronar Faruk Sylejmani dhe Violeta Rizahi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70896060 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Enisi Trade" D.O.O. Viti, Faruk Sylejmani dhe Violeta Rizahi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70896060 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Enisi Trade" L.L.C. Viti, Faruk Sylejmani dhe Violeta Rizahi, has come to the decision to quit its business: 70896060 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Bedrije Halil Ramadani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës Filllore "Dëshmorët e vitit 1921" Prapashticë.
- Bleorant Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

